

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.04.2023*

24.04.2023  
Ora 12:13

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 339, për hapje të zyrës zgjedhore nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë” në kundërshtim me udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.*

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2. Stafi KQZ:

Z. Y. Merkaç, Znj. M. Koja,

Z. E. Meta, Znj. V. Ballgjini

• **Parti Politike:**

PDIU, PD, BF.

• **TË TJERË:**

KRIIK.

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita! Atëherë, në seancën e sotme kemi 2 çështje. Një çështje që lidhet me shqyrtimin administrativ në lidhje me një denoncim për hapje të zyrës zgjedhore nga koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe çështje të mbartura nga seancat e kaluara. Ka të bëjë caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

**Znj. M. Koja:** Atëherë Komisioner, në datën 13 prill, monitoruesi i caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka paraqitur një raport për periudhën e monitorimit nga data 3 deri në 13 prill. Rezulton se është e hapur një zyrë

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.04.2023*

zgjedhore, në një distancë më të vogël se 300 metra, konkretisht 100 dhe 50 metra. Në KZAZ-në nr. 37 në Bashkinë Tiranë. Zyra zgjedhore mban postera, materiale propagandistike të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Është e ndodhur në rrugën “Artan Lenja” në kompleksin Kontakt, pallati Aries. Rezulton që kjo zyrë zgjedhore ndodhet afër një distance 150 metra nga shkolla “Gustav Mayer” ku ndodhen disa qendra votimi dhe në një distancë prej 170 metra nga shkolla “Naim Frashëri” ku edhe këtu ndodhen disa qendra votimi. I është kërkuar në zbatim të procedurave në fuqi, mbyllja e zyrës zgjedhore, subjektit zgjedhor. Pas kalimit të periudhës së njoftimit është bërë një riinspektim nga ana monitorusit në datën 20 prill, edhe rezulton që sërish zyra është e hapur. Në këto kushte ne propozojmë të merren masat nga ana e policisë bashkiake, për mbylljen e zyrës zgjedhore e cila është në kundërshtim me dispozitat e udhëzimit numër 6, të Komisionerit, në lidhje me distancën që duhet të respektohet për hapjen e zyrave zgjedhore larg KZAZ-ve, QV-ve apo vendeve të numërimit të votave, Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësues të partive politike ndonjë diskutim?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit “Bashkë Fitojmë”:** Faleminderit, zoti Celibashi! Unë shoh një tendenc të theksuar të asaj që është në kundërvënien kundrejt Opozitës qoftë edhe në këto nivele. Që janë nivele pa barazi totalisht, ju jeni tashmë i njohur me shkresën numër 369 datë 20.04.2023, shkresë e nënshkruar nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”, ku bën me dije juve, Bashkisë Tiranë, Bashkisë Durrës, Policisë Bashkiake të këtyre dy qyteteve, Policisë së Shtetit, misionit OSBE\ODIHR-it marrjen e masave urgjente për heqjen e materialeve propagandistike, statike të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë të

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.04.2023*

vendosura në shkelje flagrante me Kodin Zgjedhor në Bashkinë Tiranë kryesisht po edhe në bashki të tjera. Shoh që tendenca është për të parë se ku dhe si po procedon Koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Tendenca është kaq e madhe sa unë do të doja mos të marrim parasysh fare të atyre që janë, raporti i vëzhguesve të datës 17 për shkak se, duke shkarkuar të gjithë vëzhguesit për mos kryerje të detyrës. Për shkak se nga data 15 i nderuar zoti Celibashi, si qytetar mund të konstatojmë jo si përfaqësues të një institucioni po edhe si qytetar mund të konstatojmë, në rrugët e qytetit të Tiranës dhe në të gjitha rrugët e Shqipërisë. Rrugë urbane, interurbane , autostrada e të tjerë, konstatojmë Billboardera të mëdhenj. Ja ku e kemi dhe filmimin, e sjellim dhe në rrugë zyrtare, vetëm në rrugën dytësorë nga pjesa e mbikalimit të Aeroportit deri tek Casa Italia mund të jenë rreth 30 Billboard-e denigruese, me një gjuhë fyese, denigruese, seksiste të zotit Kryeministër të këtij vendi. Pra këto gjëra jua kanë sjellë në djeni juve, jua kanë bërë me dije, jua kanë bërë me shkresa zyrtare të gjithë? Ata që janë personat e paguar për vëzhgimin jo të njëanëshëm të një fushate zgjedhore me armë të barabarta? Nuk mbaron videoja, janë mbi 30 Billboarde vetëm në një rrugë. Shkoni në rrugën “Myslym Shyri”, shkoni në “Rrugën Kavajës”, në “Rrugën e Durrësit”, në çdo rrugë keni atë që është shpëtimtari i vendit me ngjyra, edhe këta që janë përfaqësuesit e Opozitës i ka bërë dhe pa ngjyra se atë stil denigrues përdor gjithmonë. Pra mendoj që, pavarësisht se keni sjell për shqyrtim rishtazi një akt në të cilin pretendoni se është hapur një zyrë zgjedhore në kundërshtim me udhëzimin numër 6. Mendoj që, për barazi të armëve do të duhet të shikoni fillimisht atë që po bën qeveria, ato që po bën partia Socialiste dhe pastaj të merreni me zyrat e hapura nga ana e “Bashkë Fitojmë”. Koalicioni po sillet në mënyrë shumë të ndershme me atë që është fushata zgjedhore. Nga data 15 me çeljen e fushatës... nga 14 në datën 15 ka filluar

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.04.2023*

një ushtri, e tërë gjithë reklamimi në çdo hapësirë publike dhe jo publike të bashkive. Sjell në vëmendje jo vetëm tuajën po edhe të OSBE\ODIHR-it të monitorojë papajtueshmërinë të themi të një lëvizjeje të tillë nga ana e Partisë Socialiste. Unë refuzoj të shprehem për atë që është zyra e hapur nga ana koalicionit, refuzoj të di metodikat e matjes së distancës nga ana jua. Pra e një institucioni shkollor dhe këtë gjë mund ta shqyrtojmë vetëm në momentin kur ju do të silleni si të barabartë me koalicionin që unë përfaqësoj. Vetëm kur të gjithë ata që janë personat e ngarkuar me punë nga KQZ-ja dhe persona të tjerë të kontraktuar për të dhënë një produkt objektiv dhe jo si vëzhguesit, që duhen shkarkuar të gjithë sipas mendimit tim, të sillen në mënyrë ligjore. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit zoti Kaziaj! Për djeninë tuaj dhe të përfaqësuesve të tjerë të partive politike, ne kemi vendosur të hapim procedurën administrative të shqyrtimit të denoncimeve të paraqitura nga ana juaj, por edhe nga disa organizata të shoqërisë civile në lidhje me mënyrën sesi nga pikëpamja vizuale nëpër rrugët e qyteteve po e prezantojnë fushatën elektorale edhe Partia Socialiste, por edhe subjektet e tjerë. Ka filluar ky proces i shqyrtimit administrative, po në rastin konkret është një rast i cili është sjell në vëmendje direkt nga monitoruesit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të cilët edhe për rastet të cilat juve keni bërë denoncimet apo organizatat e shoqërisë civile qoftë Qëndresa Qytetare, qoftë KRIIK ka bërë. Kanë sjellë edhe ata informacione, por për shkak të volumit të dokumentacionit që do të duhet të vlersojmë shqyrtimet janë në rradhë nesër dhe në vazhdim, por në mënyrë absolute nuk ka një qasje të diferencuar për arsye subjektive të vlersimit dhe të gjykimit të sjelljes së fushatës elektorale të gjitha partive politike dhe të gjitha subjekteve zgjedhore. Kanë edhe ato denoncimet e

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.04.2023*

bëra nga partitë e tjera po edhe nga koalicioni juaj, kanë gjithë vëmëndjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për tu trajtuar në përputhje të plotë me parashikimet e Kodit Zgjedhor, përfshirë këtu edhe sikurse thashë të ardhura nga organizata të Soshqërisë civile. Gjithësesi për rastin konkret unë mendoj që të bëhet një komunikim paraprakisht përpara se të vendosim me përfaqësuesit e subjektit dhe jam i sigurtë nëse do të verifikohet, se në fund të fundit është çështje matematike distance për të cilën po diskutojmë ndërmjet zyrës zgjedhore dhe institucionit publik dhe besoj që do të kemi të gjithë mirkuptimin pa urdhërime, me mirëkuptim të zgjidhet kjo situatë. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.04.2023*

**Data 24.04.2023  
Ora 16:02**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendim “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2. Stafi KQZ:**      **Z. Y. Merkaaj, Z. E. Meta**
- **Parti politike:**      **PDIU (Sh. Sulo, K. Xhemali)**  
   **PL (A. Kaziaj), PD (R. Kthupi)**
- **Të tjerë**      **KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Rifillojmë seancën në lidhje me projektvendimin për caktimin e partive që kanë të drejtën për të propozuar anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave. I kemi kërkuar Kuvendit të Shqipërisë për të sjellë një plotësim në lidhje me përgjigjen e parë që ka sjellë Kuvendi për kërkesën e bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për përfaqësimin shumicë-pakicë të partive politike në zgjedhjet e vitit 2017 dhe mënyrën e votimit të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë. Kemi marrë përgjigje. Jeni njohur me përgjigjen e fundit?

**Z. A. Kaziaj:** Me këtë të fundit jo.

**Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.04.2023*

**Z. I. Celibashi:** Njëkohësisht kemi edhe një shkresë të ardhur nga Partia Drejtësi, Integrim, Unitet në lidhje me qëndrimin e partisë. Fjala për përfaqësuesin e Partisë Drejtësi, Integrim, Unitet.

**Z. Sh. Sulo:** Faleminderit, zoti kryetar! Ne jemi drejtuar në lidhje me projektaktin për sa i përket anëtarit që do të përcaktohet me short në Grupin e Numërimit. Përveç dokumentacionit të marrë nga KQZ-ja, të marrë edhe nëpërmjet shërbimit të internetit, kemi depozituar ditën e sotme një shkresë në mëngjes “Informacion mbi vendimet e marra nga Këshilli Kombëtar i Partisë për Drejtësi, Integrim, Unitet”, ku tregon qartazi që kjo forcë politike është në opozitë në lidhje me situatën politike.

**Z. I. Celibashi:** Kemi diskutime të tjera?

**Z. A. Kaziaj:** Faleminderit, zoti Celibashi! Sapo u njohëm me shkresën që na vuri në dispozicion kolegu i PDIU-së. Nuk shohim ndonjë gjë, është shkresë të themi e karakterit privat, pavarësisht se ju drejtohet juve, informacion për vendimet e marra, ndërkohë që vendimet e marra të një subjekti politik janë vërtet akte të brendshme të tij, që nuk influencojnë në vendimmarrjen që përfaqësuesit e këtij subjekti në vetvete japin nëpërmjet ushtrimit të të drejtës së votës së tyre si deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, gjë të cilën ju tashmë e keni të qartë dhe ju është vënë në dispozicion edhe nga ana jonë për të gjitha votimet që janë bërë. Në Kuvendin e Shqipërisë në vitin 2022-2023, flasim e shohim vota pro për sa u përket projektligjeve ose ndryshimeve të tyre, ratifikimet e marrëveshjeve të ndryshme, pra qëndrimet që kryesisht Kuvendi sipas asaj që është kompetenca e vetë mban. Shohim që, pavarësisht një shkrese private ku thonë që janë në opozitë, PDIU qartazi ka mbajtur qëndrim pro qeverisë në 90% të rasteve kur ka qenë pjesë e votimit në parlament

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.04.2023*

nëpërmjet përfaqësuesve të vetë. Kështu që, ju lutem, të merret parasysh edhe ky fakt.

**Z. I. Celibashi:** Përfaqësuesi i PDIU-së.

**Z. Sh. Sulo:** Faleminderit, zoti kryetar! Në lidhje me imelin që e lexoi përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim, sot me emër tjetër apo në një koalicion për të cilin unë e shpreha pak më parë se nuk më pëlqen ta them, sepse nuk mundet të përfaqësojë zotëria studentët e Dhjetorit. Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet, i nderuar Kryetar, është forcë opozitare, e cila tashmë dihet botërisht dhe normalisht për të mirën e vendit ka votuar ligje ose ratifikime të marrëveshjeve ndërkombëtare siç i kanë votuar të gjithë dhe jo vetëm PDIU-ja. Ka votuar edhe buxhetin e shtetit, ku janë caktuar edhe fondet e partive, nga të cilat ka përfituar edhe partia e kolegut që është këtu prezent. Ne nuk shohim ndonjë gjë tjetër. Le të kalojmë në thelbin e çështjes, e cila lidhet me projektaktin për caktimin e numëruesit. Dihet, zoti kryetar, që KQZ-ja në momentin që përcakton sesi duhet vlerësuar një parti politike e shumicës apo opozitës parlamentare, nuk është pozicioni faktik që zënë këto parti në një moment të caktuar, por pozicioni që këto parti kanë pasur në zgjedhjet parlamentare ose të kaluara. KQZ-ja i është referuar edhe në projektaktin e paraqitur konfigurimit politik që kanë prodhuar rezultatet e vitit 2017 dhe nga kjo situatë ka rezultuar që në këto zgjedhje Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet është parti e opozitës parlamentare. Më duhet të paraqes para jush disa dokumente të marra nga media të caktuara: “PDIU koalicion të ri me PD-në”, “Partia për Drejtësi, Integrim mandaton zotin Shpëtim Idrizi në unanimitet për të përmbyllur marrëveshjen me opozitën parlamentare”. Këto vijnë të jenë të vitit 2018. Po kështu, zoti kryetar, mund të paraqes edhe një video ku përfaqësuesi i PDIU-së zyrtarizon marrëveshjen

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.04.2023*

me Bashën. Nëse do t'u referoheshim ngjarjeve të këtij viti, do të sillnim në vëmendje të këtij institucioni që ka qenë Partia Lëvizja për Integrim, partia e LSI-së, e cila ka pasur marrëveshje me Partinë Socialiste, çka prodhoi edhe marrjen e Presidentit. Më pas ndodhi edhe marrëveshja e famshme PS-PD, ku u caktuan edhe ministra nga Partia Demokratike, nga të cilët ka pasur ministra edhe vetë përfaqësuesi i koalicionit. Por po i rikthehemi edhe një herë bazës ligjore, Kodit Zgjedhor, neneve 95 dhe 96, të përcaktuar fare qartë: është parti parlamentare? Po. Ka tre deputetë? Po. Ka katër deputetë. A është pjesë e shumicës e opozitës? Patjetër që po. Përveç këtyre dy neneve, në Kodin Zgjedhor, të cilit ne i referohemi në çdo mbledhje ose projektakti që sillet, në nenin 183, pika 8: "Në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, e drejta për propozimin e anëtarit të KZAZ-së, KQV-ve dhe GNV-ve përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij pas këtyre zgjedhjeve". Nga dokumentacioni i vendosur nga ana e administratës së KQZ-së rezulton se në këtë periudhë zgjedhore PDIU-ja ka qenë në opozitë dhe sipas deklaratave të përfaqësuesve të saj Reme Lala, e pavarur, Eleni Xhixho - nuk bëj pjesë në asnjë forcë politike. Këto janë dokumente na janë paraqitur nga administrata nga ana e Kuvendit të Shqipërisë. Nuk e kuptoj se për çfarë duhet ende Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duke përmendur edhe një herë nenin 19, shkronja "dh", për sa i përket Komisionerit për zbatimin e këtij Kodi. Komisioneri nuk do të bëjë vlerësime politike, por do të bëjë vlerësime ligjore për sa i përket kësaj çështjeje. Pra, janë të gjitha këto argumente, të cilat ju, i nderuar zoti Komisioner, duhet të miratoni projektaktin e sjellë nga administrata. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.04.2023*

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesi i Partisë Demokratike dhe pastaj përfaqësuesi i Partisë së Lirisë.

**Z. R. Kthupi:** Zoti Komisioner, që të mos i hyjmë kësaj lojës së deklarimeve subjektive apo objektive, po i referohem 15/1 të Rregullores së Kuvendit, titulli i nenit: “Deklarimi i pozicionit politik të grupeve parlamentare. Kryetari i grupit parlamentar brenda një jave nga formimi i grupit dorëzon një deklaram me shkrim te Kryetari i Kuvendit për pozicionimin politik të grupit parlamentar pro ose kundër subjektit politik të koalicionit qeverisës pasi merr edhe miratimin me shkrim të subjektit politik”. Në këto kushte, që të evitojmë pjesën e subjektivitetit se në cilin pozicionim ndodhet PDIU-ja, Kuvendi duhet të kishte kthyer përgjigje me shkrim nëse ky subjekt nga fillimi i seancës plenare të Kuvendit apo në krijimin e grupeve parlamentare e ka deklaruar pozicionimin e tij politik nëse është pro apo kundër subjektit qeverisës. Fakti që PDIU-ja voton në disa ligje pro dhe në disa ligje kundër nuk e bën automatikisht subjekt të pozitës apo të shumicës qeverisëse, as nuk e bën automatikisht opozitë. Kështu që duhet të ishte përgjegjësi e Kuvendit në këto kushte që të deklaronte ose të jepte me shkrim përgjigjen në lidhje me pozicionimin e subjektit në momentin që është krijuar grup parlamentar ose në momentin kur ka filluar seanca e Kuvendit, legjislatura.

**Z. I. Celibashi:** Përfaqësuesi i Partisë së Lirisë.

**Z. A. Kaziq:** Zoti Komisioner, e tha edhe kolegu i PDIU-së që dy emrat e deputeteve që lexoi, të cilat janë zgjedhur nën siglën e PDIU-së, kanë deklaruar me vullnetin e tyre të lirë që janë të pavarura, pra nuk i përkasin asaj force politike. Kështu që kjo është fare e qartë. Nuk kemi informacion tjetër nga Kuvendi dhe habitem që me dy

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.04.2023*

shkresa vijnë dy përgjigje, me sa shoh, të karakterit minimalist mund t'i quaj në vetvete, pa dhënë asnjë lloj indicie, pa dhënë asnjë lloj ndihme në të mirë të procesit këtij institucionit, pra institucionit që ju drejtoni. Më vjen keq, por nuk janë fakte historike këto që unë tregova në pjesën e parë të fjalës sime që me kë ka bërë koalicion partia që unë përfaqësoj, por edhe vetë koalicioni në vetvete, e në qëndrime publike të PDIU-së, e cila nuk duket të dalë e të bëjë kundërshtim në vetvete, po bën vite pa kundërshtuar në vetvete nëpërmjet përfaqësuesve të saj qeverinë, vendimmarrjet e qeverisë, qoftë në parlament, qoftë edhe jashtë tij, ka të gjithë detyrimin, për shkak të votuesve të vetë, duke qenë se është zgjedhur në opozitë si forcë politike, të mos i tradhtojë ata nëpërmjet skjerimit në një pozicion privilegjues duke u bërë kështu pjesë e qeverisë. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit!

**Z. Sh. Sulo:** Edhe në këto zgjedhje, i nderuar Kryetar, dihet tashmë që ne kemi kandidatin tonë për sa i përket Bashkisë Tiranë. Duke iu referuar Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, çdo deputet në mënyrë të pavarur voton dhe ka integritetin e tij. Nëse PDIU do të ishte në pozitën parlamentare, do të kishte një marrëveshje, siç ndodh rëndom në politikën shqiptare. Unë vë re që kolegu nuk solli asnjë lloj argumenti, thjesht na lexoi disa imeile që na paskan votuar deputetët e PDIU-së ratifikimin e marrëveshjeve. Atëherë po flasim që duhet të jemi konform edhe ndërkombëtarëve, pra Amerikës. Nuk duhet të votojmë marrëveshjet e Amerikës? Që do të thotë argumente të sjella në kundërshtim të këtij projektakti nuk janë jo ligjore, por edhe të vërteta. PDIU, i nderuar zoti Kryetar, vazhdon të jetë në opozitë siç ka dalë nga zgjedhjet pararendëse. Prandaj, ju lutem, që të mos humbasim kohë, të votojmë, të jepni vendimin tuaj për këtë projektakt.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.04.2023*

**Z. I. Celibashi:** Do t'jua jap fjalën me mirëkuptim nëse përfaqësuesi i PDIU-së nuk do ta marrë përsëri fjalën pas jush.

**Z. Sh. Sulo:** Varet se çfarë do të thotë.

**Z. A. Kaziaj:** Nuk do të shaj marrëveshjet me amerikanët. Ishte një nga marrëveshjet e ratifikuara, nuk e cilësova se cila marrëveshje ishte. Sjell në vëmendje të vendimmarrjes suaj se jeni ju ai që do të vendosni nëpërmjet vendimit tuaj faktin që para pak javësh u hodh edhe shorti publik në këtë sallë për partitë garuese në fletën e votimit në 61 bashki. Në qoftë se nuk kam memorie të keqe, ishin tre parti ose tri subjekte: ishte koalicioni që unë përfaqësoj, ishte Partia Socialiste, ishte edhe Partia Agrare Ambientaliste. Pra, pasja edhe në këtë mënyrë të një numëruesi në tavolinën e numërimit për të numëruar votat e PDIU-së, ndërkohë që PDIU-ja nuk është në vetvete në fletë votimit. Çfarë kuptimi do të kishte në vetvete? Votat e kujt do të mbrojnë numëruesi i PDIU-së në momentin që subjekti që ai përfaqëson nuk rezulton të jetë në fletën e votimit nëpërmjet kandidatit me siglën, logon dhe emrin e subjektit?

**Z. I. Celibashi:** E fundit dhe shpresoj që të mos keni më replikë.

**Z. Sh. Sulo:** Zoti kryetar, nëse jemi në këtë sallë dhe shikojmë se cila është përmbajtja e fletëve të votimit, një nga 5-6 kandidatët e Bashkisë Tiranë, është Lajla Pernaska, është përfaqësuesja e PDIU-së, dhe normalisht detyrimi që ka ky subjekt zgjedhor për t'u përfaqësuar, për t'u ndjerë krenar me këtë kandidate, ka edhe detyrimin ligjor që ia njeh edhe Kushtetuta, edhe ligji që t'i numërojnë votat. Nuk do

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.04.2023*

të zgjatem për sa i përket tradhtisë së kauzës apo çfarë do të numërojë. Unë kam një pyetje për përfaqësuesin e Lëvizjes për Integrim apo “Bashkë Fitojmë” ose Partisë së Lirisë: Çfarë votash do të numërojë ky përfaqësues për kandidatin e Himarës? Çfarë votash do të numërojë për një kandidat, i cili ka marrë gjak shqiptarësh? Çfarë votash do të numërojë ky përfaqësues për kandidatin e Himarës që ka shkelur simbolet e kombit shqiptar? Është shumë e rëndë, prandaj nuk dua të flas. Se çfarë votash do të numërojmë ne, na i jep ligji, prandaj për të qenë më korrektë, do t’ju lutesha, zoti Kryetar, që të kalojmë ne vendimmarrjen tuaj për këtë gjë. Nëse është për të folur, vazhdojmë e flasim përsëri, se kemi argumente akoma dhe më shumë. Nuk mund të lejoj që kjo tavolinë të përdoret nga përfaqësuesi për të bërë politikë apo për gjëra të tjera, sepse kemi shumë e shumë gjëra për të thënë. Më habit fakti që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka shtyrë disa herë edhe për arsye objektive, por që të tundohet apo intimidohet nga kërkesat e këtij përfaqësuesi nuk shkon.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesi i Partisë Demokratike dhe do ta mbylлим seancën për parashtrimet e të gjithë përfaqësuesve të partive politike në lidhje me këtë çështje.

**Z. R. Kthupi:** Faleminderit, zoti Komisioner! Nga nocioni si e kuptoj unë ligjin dhe fakti që në tryezë ka katër numërues, katër subjekte të ndryshme politike, nuk është se këta shkojnë për të numëruar votat e veta, një formë balance që ligjvënësi e ka krijuar në mënyrë që të gjitha palët të kenë të garantuar një numërim sa më të drejtë e korrekt të votave, kështu që nuk caktohet numërues i një partie përkatëse politike, sepse ka tagrin për të numëruar apo ka për objektiv për të numëruar votat e veta. Kjo është balanca e krijuar për të pasur një numërim të drejtë. Në qoftë se ne do të shkojmë me idenë që PDIU-ja do të numërojë vetëm votat e veta, do të thotë që

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.04.2023*

sistemi ka ceduar tashmë. Në këto kushte nuk ka lidhje se kush është numëruesi që caktohet për atë kohë sa qëllimi që ka ligjvënësi është që të krijojë barazinë e armëve mos pozitës dhe opozitës ose një *check and balance* për atë që është numërimi i votave. Unë gjykoj, zoti Komisionier, që projektakti që është hartuar, duhet miratuar në formën që është, pasi në perceptimin të paktën që ne kemi, PDIU-ja vazhdon të mbetet një parti opozitare, pavarësisht të gjitha diskutimeve që u bënë.

**Z. I. Celibashi:** Po.

**Z. A. Kaziq:** Të fundit e kam dhe po e mbyll. Nuk është për replikë, sepse fakti është që e paska keqinterpretuar vullnetin e ligjit derisa në momentin kur caktohet një parti dhe një subjekt për të pasur një numërues, normale që numëruesi është subjekti që e cakton te numërimi. Normale që e cakton për të parë procesin në tërësi, në vetvete, për të mbrojtur votën. Këto janë dy aspektet kryesore të caktimit të numëruesit sipas asaj që janë parashikimet e ligjit, jo se ligjvënësi ka pasur tjetër frymë.

**Z. I. Celibashi:** Nuk do të mbarojmë kështu.

**Z. Sh. Sulo:** Vetëm pak sekonda. I nderuar Kryetar, referuar neneve 95, 96, dispozitës kalimtare të nenit 183, referuar edhe vendimit të Kolegjit Zgjedhor për këtë çështje, unë besoj se janë të gjitha arsyet ligjore konform Kodit Zgjedhor që ky projektakt të kalojë siç është paraqitur nga administrata. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Pasi të gjithë ju keni dhënë mjaftueshëm argumente në lidhje me këtë projektvendim, pro dhe kundër draftit të propozuar, mendoj që, edhe pse e kuptoj shumë mirë për hir të së vërtetës sensibilitetin që kanë të gjithë kur vjen puna

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.04.2023*

te komisionerët apo tek anëtarët e grupeve të numërimit, në fakt duhet të prezumohet që ata janë aty, edhe pse vijnë të propozuar nga partitë politike, thjesht dhe vetëm përfaqësues të ligjit dhe janë garant nga pikëpamja teknike e administrimit të procesit zgjedhor, si të procesit të votimit, ashtu edhe të procesit të numërimit. Thënë këtë, edhe anëtarët e grupeve të numërimit, pavarësisht se propozohen nga parti politike të shumicës dhe pakicës parlamentare, në fakt janë aty si ekzekutorë të një procesi administrativ, por është e qartë që mungesa e madhe e besimit ndërmjet palëve politike në këtë vend, sidomos gjatë garave elektorale, i bën ato që të kenë një fokus të shtuar mbi këtë çështje dhe interes të shtuar se kush është komisioner dhe kush është numërues. Nga ana tjetër, gjej rastin për të rikonfirmuar që edhe pse ka atë rëndësi që ka për ju se kush i propozon anëtarët e grupeve të numërimit, mendoj që sistemi i cili tashmë nga Komisioni qendror i Zgjedhjeve, veçanërisht pas zgjedhjeve të vitit 2021 dhe të zgjedhjeve të vitit 2022, është i konsoliduar mjaftueshëm për t'u dhënë garanci edhe atyre që nuk kanë as numërues, as komisioner për të vlerësuar drejt fletët e votimit që gjenden në kutitë e votimit. Jeni dëshmitarë që ne kemi bërë rivlerësimet e fletëve të votimit mbas këqyrjes të fletëve votimit pas përfundimit të procesit zgjedhor dhe në rastin e zgjedhjeve të votimit për partitë politike në zgjedhjet e vitit 2021 edhe gabimet njerëzore kanë qenë të papërfillshme, kanë qenë lëvizje me maksimumin 1 ose 2 vota, ka qenë pak më e theksuar kjo diferencë në rastin e votave për kandidatët, por në çdo rast nuk ka shkuar më shumë se 80 vota nga ajo çfarë ne kemi verifikuar në raport me rezultatin zyrtar të shpallur dhe kjo i dedikohet pa dyshim edhe korrektesës së treguar nga anëtarët e grupeve të numërimit, por edhe gjithë sistemit të monitorimit që ka ndërtuar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. E sigurt që nuk kemi të gjithë iluzione që gjithçka ka shkuar perfekte kudo, por problematikat kanë qenë thuajse të papërfillshme në kuptim të integritetit të numërimit dhe vlerësimit të fletëve të

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.24.04.2023*

votimit, ndaj në gjykimin dhe vlerësimin tim ky merak juaj është jo fort i justifikuar. Për t'u kthyer te thelbi i çështjes, mendoj që dispozita tranzitore të cilës duhet t'i referohemi dhe të gjithë duhet ta pranojmë që kësaj dispozite duhet t'i referohemi se cila do të jetë përbërja e grupeve të numërimit edhe për këto zgjedhje, në gjykimin tim e ka të përcaktuar qartë se kush është shumicë e kush është pakicë e kujt i takon e drejta për të propozuar anëtarë të grupeve të numërimit për këto zgjedhje. Edhe pse çuditërisht them që, edhe pse ndryshimet e Kodit Zgjedhor janë bërë në mesin e vitit 2020, në korrik në mos gaboj, ka qenë e ditur se cilat kanë qenë partitë e shumicës e të pakicës parlamentare në vitin 2017, kështu që do të ishte më mirë që në fakt të na e kishte kursyer të gjithëve këtë debat dhe ligjvënësi të kishte listuar partitë, sepse dihet si janë zhvilluar zgjedhjet në vitin 2017 dhe është ditur se cilat kanë partitë e shumicës dhe pakicës parlamentare në momentin kur Kuvendi është konsituuar. Mund t'i kishte rënë shkurt duke i listuar këto si parti, por dispozita është kështu siç është shkruar dhe në gjykimin tim mendoj që qëndrojnë argumentet e dhëna nga përfaqësuesi i Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet dhe kanë të drejtën që ata së bashku me Partinë e Lirisë të përfshihen në shortin për caktimin e anëtarit të tretë e të katërt të grupit të numërimit. Pra, mendoj që drafti që është propozuar nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Faleminderit! Procedurat e shortit i zhvillojmë nesër, apo doni t'i zhvillojmë sot? Nëse palët janë dakord? Nëse kemi konsensus për tani, e zhvillojmë tani, nëse ... E lëmë për nesër meqë nuk kemi konsensus. Short është në fund të fundit. Nesër në orën 12.

**Vendimi nr. 404**

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

